

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

INFORMACION I DHËNË MË PARË

Autoriteti publik bën të mundur që informacioni, i cili i është dhënë të paktën një herë një kërkuesi, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen.

Fryma e nenit 8 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" i cili parashikon se autoriteti publik mban dhe regjistron të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre, është pikërisht me qëllim për ti bërë të njohur publikut të gjitha informacionet që kërkohen më shpesh dhe përgjigjet e tyre.

Nëpërmjet urdhrit nr. 188 datë 18.12.2020 Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miratoi modelin e Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar, model i cili duhet të zbatohet nga të gjitha autoritetet publike. Autoritetet Publike detyrohen të publikojnë përveç numrit rendor të kërkesave, datën e regjistrimit të kërkesës dhe përgjigjes, objektin e kërkesës, përgjigjen e plotë si dhe tarifën përkatëse nëse ka.

Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik.

Kërkesat për informim për informacione të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve plotësohen jo më vonë se 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së kërkesës.

Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim Nr. 46 - Bashkia Kamëz

**Vendim Nr. 47 - Spitali Universitar
Shefqet Ndroqi**

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit tetor 2021, ka dhënë 2 vendime urdhërimi në zbatim të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit”.

Me anë të vendimit nr.47, datë 18.10.2021, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj “Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” (Autoriteti Publik), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, ku kërkohej informacion për vitet 2019/2020 dhe periudhën Janar - Qershor 2021 mbi:

- Numrin e pacientëve të shtruar dhe trajtuar me Covid 19
- Numrin e pacientëve të infektuar me Covid 19 që kanë pasur nevojë për oksigjen medikal.
- Numrin e operacioneve të kryera
- Një kopje të procedurave të tenderave të zhvilluar nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” për furnizimin me oksigjen medikal p
- Një kopje të kontratave të lidhura nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”

Në mungesë të një përgjigje nga ana Autoritetit Publik, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurave administrative, KDIMDP kërkoi nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion. Pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit, Autoriteti Publik ka vlerësuar dhënien e informacionit. Autoriteti Publik, në përgjigjen e tij argumentoi se: Në zbatim të Rregullave të Prokurimit Publik, procesverbalet e mbajtura janë personale dhe konfidenciale pasi aty janë firmat dhe emrat e anëtarëve të komisioneve dhe dhënia e këtyre dokumentacioneve përbën shkelje të rregullave të ruajtjes së konfidencialitetit. Njëkohësisht, DST-Dokumente Standarte të Tenderit ashtu si të gjitha procedurat janë transparente dhe shumë

#informim #transparencë #vendim

lehtë të verifikueshme në faqen zyrtare Agjencisë së Prokurimit Publik.

Nga shqyrtimi i çështjes, Komisioneri konstatoi se, dokumentacioni i kërkuar ka të bëjë me një procedurë prokurimi publik, e cila i nënshtrohet dispozitave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (ligji i zbatueshëm në atë kohë), si dhe ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Neni 25 i ligjit nr. 9643, datë 30.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakton kufizime mbi autoritetin publik lidhur me publikimin e informacionit të marrë nga operatorët ekonomikë, të cilësuar si konfidencial, duke përfshirë në këtë kategori aspektet teknike, sekretet tregtare, si dhe informacionet konfidenciale të ofertave. Kufizim, ky i parashikuar edhe në nenin 16 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Siç mund të vërehet nga dispozita e mësipërme, konfidencialiteti lidhet me aspekte teknike, sekrete tregtare dhe të dhëna të tjera konfidenciale me të cilat Autoriteti Publik është njohur ose i janë vënë në dispozicion nga operatorët ekonomikë gjatë procesit të prokurimit publik. Pra, në këtë përcaktim nuk përfshihen kontratat për punë, blerje produkte apo shërbime publike, procesverbalet, raportet teknike që mund të mbajë autoriteti publik gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit publik, e cila edhe nga vetë emri është vetëshpjeguese për natyrën e saj. Për më tepër, Zyra e Komisionerit sqaron se një pjesë e informacionit të kërkuar bën pjesë në atë kategori informacioni, që duhet të bëhet publik pa kërkesë.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik për mosdhënien e informacionit nuk rezulton i bazuar në ligj.


Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesës, KDIMDP vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit të kërkuar duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.


TRANSPARENCA PROAKTIVE E AUTORITETEVE PUBLIKE

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi dy takime në funksion të përmirësimit të transparencës proaktive dhe rritjes së llogaridhënies së Autoriteteve Publike.


Aktiviteti i organizuar me Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive dhe koordinatorët e të drejtës për informimit të këtyre institucioneve pati në fokus përmbushjen e detyrimeve ligjore për garantimin e të drejtës për informim dhe funksionalizimin e plotë të Programit të Transparencës, sipas modelit të miratuar në 18.12.2020. Objekt diskutimi ishin konstatimet e Zyrës së Komisionerit gjatë monitorimeve të kryera, ku kryesisht problematik mbetet plotësimi me informacion i të gjithë rubrikave të Programit të Transparencës. Ky instrument është nga burimet kryesore të informacionit për publikun apo grupet e interesit dhe shpreh nivelin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së Autoriteteve Publike. Në takim u trajtua edhe çështja e përmirësimit të procesit të kthimit të përgjigjeve për kërkesat për informacion në afat dhe në përmbajtje, ndërsa, u theksua edhe forcimi i rolit të koordinatorit nëpërmjet rritjes së aksesit brenda strukturës së Autoritetit Publik.



Aktiviteti i organizuar me Kryetarët e Bashkive apo funksionarë të tjerë të lartë, si dhe me koordinatorët e të drejtës për informim pati në fokus problematika që lidhen me transparencën e njësive të vetëqeverisjes vendore. Modeli i Programit të Transparencës për këtë kategori Autoritetesh Publike është i zbatueshëm prej 1 janarit 2019 dhe reflekton veçoritë e tyre në raport me shërbimet që ofrojnë për qytetarët. Nga monitorimet e vazhdueshme, Zyra e Komisionerit konstaton ende problematika në këtë drejtim, si mosnjohje e duhur e detyrimeve ligjore apo dhe mungesë e angazhimit institucional. Zyra e Komisionerit kërkoi nga titullarët e këtyre institucioneve marrjen e masave dhe sidomos, monitorimin e vazhdueshëm për përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore. Po ashtu, shprehu gatishmërinë për të asistuar dhe ofruar trajnime për këtë qëllim për koordinatorët apo struktura të tjera të Autoriteteve Publike.



Balanca mes dy të drejtave në veprimtarinë e Autoriteteve Publike të sektorit shëndetësor



Transparencë ndaj publikut duke garantuar respektimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve. Ishte kjo tematika e trajnimit të zhvilluar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me koordinatorët për të drejtën e informimit dhe personat e kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale të Autoriteteve Publike që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin shëndetësor.

Në aktivitetet u trajtuan çështje të zbatimit të kuadrit ligjor në këto fusha në vlerësim të balancuar mes dy të drejtave, si dhe për problematikat e hasura në raport me përballimin e situatës së pandemisë Covid-19. Vëmendje iu kushtua plotësisht dhe përditësimit të rubrikave të Programit të Transparencës për forcimin e transparencës proaktive, duke rritur cilësinë e informacionit për publikun. Gjithashtu, u trajtua ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale shëndetësore, të cilat kategorizohen si sensitive dhe për to garantohen një nivel më i lartë mbrojtjeje. Ndërsa, nëpërmjet rasteve nga praktika, u diskutua edhe për trajtimin e kërkesave të subjekteve të të dhënave (individët), si dhe për rolin e funksionet e personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale në këtë proces

